Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**30.10.2023**	**08.11.2023**	**2023/0799**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.10.2023, OE "NIKA PrO- Ing SH.P.K."- Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0799, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Beni Company"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi ndertimor e arkitektonik i objekteve te trajtimit dhe shperndarjes" me nr. të prokurimit: "70433736-23-8926-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A..

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 120,000 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0799 i dt:16.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e keni rekomanduar për kontratë Beni Company Sh.P.K. neve na keni eliminuar per makineri edhe pse kem dergu sqarimin e kerkuar nga ju. Edhe pas kerkes per ri-shqyrtim prap AK-ja ka vepruar kunderligjit dhe RROUP

Ne kerkes per qasje ne dokumentacion me dt. 02.10.2023 AK na ka japun mundesi per qasje menjeher me dt 03.10.2023 dhe ne qasjen e dokumentacionit te ketij tenderi kemi verejtun se OE i rekomundauar per kontrate nuk i ploteson Kerkesat e kerkuar ne dosjen e tenderit:

Pika 1. Ne kerkesen e DT eshte kerkuar qe: **5.Operatori Ekonomik (tenderuesi) me tenderin e tij duhet te vertetoje se ka ne pronesi te vet nje bager *ose* mini-bager per nevojat e ekzekutimti te projektit. Deshmia 5. Kontrata e shitje-blerjes se pajisjes ose fatura e pageses ose dokumentet per zhdoganimin e pajisjes.**

Ne ne oferte kemi dorezuar listen mareveshje me Bageri Company mandej ne kereksen e juaj per sqarim ne ju kemi dorezuar kontraten te cilen e kemi me kompany Bageri edhe eshte plotesuar kjo kerkes e juaj,

Ju njoftojm se Kerkesa per leter sqarim nuk na eshte ardhun ne e-mail mirpo kete e kemi verejtun pase telefonates nga zyra e prokurimit, dhe ne ate jemi pergjigjun si si AK- duhe te respektoni nenin 38.6 ku ceket se AK- duhet te kerkoj afat kohore te arsyeshem.
Ne kemi ofruar kontraten me Bageri Company e cila kontrate eshte originale dhe e kemi cekun se ne e posedojm eskavatorin ne punishte tone, ju kemi dhene sqarim qe nuk eshte kerkuar transaksioni bankare as fatura.

Pika 2. Ne ne qasjen e dokumentacioni te OE i rekomanduar per kontrate kemi verejtun se pagesa e bere permes e-banking nuk eshte e sakt sepse per pjesen e pare jane dy data e sistemi i e-banking nuk munde te jep dy data per nje pages, kerkojm ta vertetoni nese keni interes ju si AK- qe ti kerkon qarkullimin bankare kesaj kompanie pasi ka mos perputhje te datave te trasnaksionit. Kjo po e kupton qe eshte shtyp flet pagesa 07.02.2021 ende pa u kryer pagesa 08.02.2021.

Deshmi:

ProCredit Bank 07.02.2021 07:58:47 Statusi: Aprovuar / Approved e-Banking

Urdhër-pagesë kombëtare /National Payment Order

Të dhënat mbi urdhëruesin /Ordering customer details Ref: 539359778

Nr. i llogarisë /Account No.: XK051110341086000134
Emri/Name: BENI COMPANY SHPK
Adresa /Address: KALABRI- AGIM QELA,NN,Prishtine

Të dhënat mbi përfituesin /Beneficiary Details

Nr. i llogarisë /Account No.: XK051701003030992776
Emri/Name: SHAIP THAQI
Emri i bankës /Bank name: NLB Prishtina
Adresa /Address: GLLOCOVC
Valuta, Shuma /Currency, Amount: EUR 2800.00

Të dhënat mbi pagesën /Payment details: PAGESA E PJESRISHME PER BLERJEN E BAGERIT ME NR. SERIK D1105-XQ0357-KUBOTA NGA BENI COMPANY PER SHAIP THAQI

Tarifa e bankës /Bank's charge: 0.80 Kursi i këmbimit/Exchange rate: 1.000000

Ky urdhër transferi është pranuar nga dega e-Banking por transferi do të inicohet vetëm pasi të janë kryer kontrollat e mëtejme. Ky tranfer i nënshtrohet Rregullave dhe Kushteve të Përgjithshme të ProCredit Sh.a. (shih në fund të formularit).
This transfer order has been accepted by the branch e-Banking but the transfer will be initiated only after further checks have been performed.
This transfer is subject to the General Terms and Coditions of ProCredit Sh.a. (see bottom of the form)

Kodi i transaksionit/Transaction code 999

Përshkrimi i transaksionit/Description of the transaction

PAGESA E PJESRISHME PER BLERJEN E BAGERIT ME NR. SERIK D1105-XQ0357-KUBOTA NGA BENI COMPANY PER SHAIP THAQI

Data/Date: 08.02.2021

CONFIRMED
Date: 08.02.2021
ProCredit Bank

Deshmia 2, qe data e pagese jane konform

30.04.2021 08:40:39

ProCredit Bank Statusi: Aprovuar / Approved e-Banking

Urdhër-pagesë kombëtare /National Payment Order

Të dhënat mbi urdhëruesin /Ordering customer details Ref: 546628853

Nr. i llogarisë /Account No.: XK051110341086000134
Emri/Name: BENI COMPANY SHPK
Adresa /Address: KALABRI- AGIM QELA;NN,Prishtine

Të dhënat mbi përfituesin /Beneficiary Details

Nr. i llogarisë /Account No.: XK051701003030992776
Adresa /Address: DRENAS
Emri/Name: SHAIP THAQI
Emri i bankës /Bank name: NLB Prishtina
Valuta, Shuma /Currency, Amount: EUR 3000.00

Të dhënat mbi pagesën /Payment details: PAGESA E MBETUR PER BLERJEN E BAGERIT ME NR.SERIK D1105-XQ0357-KUBOTA NGA BENI COMPANY PER SHAIP THAQI

Tarifa e bankës /Bank's charge: 0.80 Kursi i këmbimit/Exchange rate: 1.000000

Ky urdhër transfer është pranuar nga dega e-Banking por transferi do të inicohet vetëm pasi të jenë kryer kontrollat e mëtejme. Ky tranfer i nënshtrohet Rregullave dhe Kushteve të Përgjithshme të ProCredit Sh.a. (shih në fund te formulari).
This transfer order has been accepted by the branch e-Banking but the transfer will be initiated only after further checks have been performed.
This transfer is subject to the General Terms and Coditions of ProCredit Sh.a. (see bottom of the form)

Kodi i transaksionit/Transaction code 999 Përshkrimi i transaksionit/Description of the transaction

PAGESA E MBETUR PER BLERJEN E BAGERIT ME NR.SERIK D1105-XQ0357-KUBOTA NGA BENI COMPANY PER SHAIP THAQI

Data/Date: 30.04.2021

CONFIRMED
Date: 30.04.2021
ProCredit Bank

Pika 3. OE i rekomanduar nuk e ploteson kerkesen **Kerkesa 3.Se paku dy-2 teknik te kualifikuar te ndertimtarise.** OE e ka z. Shaqir Halitin i cili është teknik i arkitektures nuk eshte teknik i ndertimtarise, pasi qe drejtimi ndertimtari duhet te jete edhe lemia ndertimtari qe te plotesohet ky kusht.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
Kerkesa 1.Nje menaxher te projektit, Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi Konstruktiv, Hidroteknik ose Arqitekturë, sistemi i para-Bolonjes ose master i shkencave sistemi i Bolonjes, me përvoje minimale prej 5 vite ne menaxhimin e projekteve te ngjajshme;	Evidenca 1. -Kopja e noterizuar e diplomes; -Kopja e CV-së, me te dhenat e kerkuara ne kerkese rreth pervojes;dhe -Kopja e kontrates valide te Punes;
Kerkesa 2.Nje udheheqes te projektit (punimeve), Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv, sistemi i para-Bolonjes ose i Bolonjes, me përvoje minimale prej 3 vite ne menaxhimin e projekteve te ngjajshme;	Evidenca 2. -Kopja e noterizuar e diplomes; -Kopja e CV-së, me te dhenat e kerkuara ne kerkese rreth pervojes;dhe -Kopja e kontrates valide te Punes;
Kerkesa 3.Se paku dy-2 teknik te kualifikuar te ndertimtarise.	Evidenca 3. -Kopje e diplomes ose e certifikates rreth pergaditjes profesionale; -Kopja e kontrates valide te punes.
Kerkesa 4.Operatori Ekonomik (tenderuesi) me tenderin e tij duhet te vertetoj se ka kryer se paku nje projekt (kontrate) te ngjajshme ne 3 vitet e fundit, duke filluar numerimin mbrapa, nga data e njoftimti per kontrate;	Evidenca 4.(i) kur puna është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij liferimi ekzekutimi shërben kopja e kontrates ose references ose ndonje certifikate tjeter relevante të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë Autoriteti Kontraktues; (ii) kur puna është bërë për një klient privat, për dëshmi të këtij liferimi ekzekutimi shërben kopja e kontrates ose references ose dokumenti tjeter të nënshkruar nga klienti bleresi;
Kerkesa 5.Operatori Ekonomik (tenderuesi) me tenderin e tij duhet te vertetoje se ka ne pronesi te vet nje bager ose mini-bager per nevojat e ekzekutimti te projektit	Deshmia 5. Kontrata e shitje-blerjes se pajisjes ose fatura e pageses ose dokumentet per zhdoganimin e pajisjes.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

VENDIM

Cilesohet e **PA BAZUAR** Kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.

SQARIM

Me daten 04.10.2023, Operatori Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.ka parashtruar tek Autoritetit Kontraktues Kerkese per Rishqyrtim, me pretendimet si me poshte:

I.1 Pretendimet e pergjithshme te OE mbi dispozitat e shkelura te LPP 04/L-042 nga Autoriteti Kontraktues:
Neni 1
Neni 7
Neni 59
Neni 60
Neni 69

I.1 Sqarimet e AK mbi pretendimet e pergjithshme te OE mbi dispozitat e shkelura te LPP 04/L-042

Neni 1-Ne LPP 04/L-042, neni 1, paragrafi 1, mes tjerash thote: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente **dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike"**.

Mbi kete baze AK ka bere vleresimin, duke u bazuar ne efikasitet, transparence, integritet dhe kulturen institucionale, pa anashkaluar asnjehere ate qe thuhet me lart si "….**më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike…".** Pretendimi per shkelje te nenit 1, nga ana e AK cilesohet **plotesisht i Pabazuar.**

Neni 7- Ne LPP 04/L-042, neni 7, paragrafi 1&2, mes tjerash thone: "-…Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. -Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

AK gjate vleresimit ka vepruar ne perputhje te plote me rekomandimet e ketij neni, sepse ju ka dhene mundesine e dhenies se sqarimeve, kthimit te tyre dhe plotesimit te dokumenteve ekzistuese me sqarime e plotesime shtese, madje duke ju kerkuar 2/dy here sqarime por ju, ne anjserin rast nuk keni kthyer pergjigjet brenda afatit te kerkuar ne letrat standarde per sqarim te tenderit. **Pretendimi per shkelje te nenit 7, nga ana e AK cilesohet plotesisht i Pabazuar.**

Neni 59- Ne LPP 04/L-042, neni 59, paragrafi 2, mes tjerash thote: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues". AK ka aplikuar ne teresi kete nen, duke ju kerkuar dy/2 here sqarime. **Pretendimi per shkelje te nenit 59, nga ana e AK cilesohet plotesisht i Pabazuar.**

Neni 60-*Ne LPP 04/L-042, neni 60, paragrafi 1, mes tjerash thote: "…*Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar **1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Pra rekomandimi eshte qe "kontraten i jap operatorit me tenderin e përgjegjshëm. Komisioni i vleresimit ne kuader te AK ka konstatuar se ju nuk keni qene i pergjegjshem as sa u perket afatit te pergjigjeve por as sa u perket deklarimeve rreth sqarimeve te kerkuara. **Pretendimi per shkelje te nenit 60, nga ana e AK cilesohet plotesisht i Pabazuar.**

Neni 69 *– Ne LPP 04/L-042, neni 69, paragrafi 1, mes tjerash thote:"... Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës".*
Ne lidhje me PRETEDIMIN per shkelje te nenit 69, AK ka kerkuar ne dosjen e tenderit kerkesat kualifikuese mbi mundesite tekniek profesionale.Ne mesin e tyre ka qene edhe kerkesa per makinerine perkatese, AK detajen i je ne trajtimin e pikes 1. **Pretendimi per shkelje te nenit 69, nga ana e AK cilesohet plotesisht i Pabazuar**

I.2 Pretendimet tjera te OE
Pika 1. Ne kerkesen e DT eshte kerkuar qe: *5.Operatori Ekonomik (tenderuesl) me tenderin e tij duhet te vertetoje se ka ne pronesi te vet nje bager ose mini-bager per nevojat e ekzekutimti te projektit.*
Deshmia 5. Kontrata e shitje-bleries se pajisies ose fatura e pageses ose dokumentet per zhdoganimin e pajisjes.
Ne ofërte keni dorezuar listen mareveshje me Bageri Company mandej ne kereksen e juaj per sqarim ne ju kemi dorezuar kontraten te cilen e kemi me kompany Bageri edhe eshte plotesuar kjo kerkes e juaj.
Ju njoftojm se Kerkesa per leter sqarim nuk na eshte ardhun ne e-mail mirpo kete e kemi verejtun pase telefonates nga zyra e prokurimit, dhe ne ate jemi pergjigiun si AK- duhe te respektoni nenin 38.6 ku ceket se AK- duhet te kerkoj afat kohore te arsyeshem.
Ne kemi ofruar kontraten me Bageri Company e cila kontrate eshte originale dhe e kemi cekun se ne e posedojm eskavatorin ne punishte tone, ju kemi dhene sqarim qe nuk eshte kerkuar transaksioni bankare as fatura.
Pika 2. Ne ne qasjen e dokumentacioni te OE i rekomanduar per kontrate kemi verejtun se pagesa e bere permes e-banking nuk eshte e sakt sepse per pjesen e pare jane dy data e sistemi i e-banking nuk munde te jep dy data per nje pages, kerkojm ta vertetoni nese keni interes ju si AK- qe ti kerkon qarkullimin bankare kesaj kompanie pasi ka mos perputhje te datave te trasnaksionit. Kjo po e kupton qe eshte shtyp flet pagesa 07.02.2021 ende pa u kryer pagesa 08.02.2021.
Pika 3. OE i rekomanduar nuk e ploteson kerkesen Kerkesa 3.Se paku dy-2 teknik te kualifikuar te ndertimtarise. OE e ka z. Shaqir Halitin i cili eshte teknik i arkitektures nuk eshte teknik i ndertimtarise, pasi qe drejtimi ndertimtari duhet te jete edhe lemia ndertimtari qe te plotesohet ky kusht.
Gjithashtu nuk eshte respektuar edhe kriteri kryesor për dhenie te kontrates e qe ka qene tenderi i pörgjegjshem me çmimin më te ulet siç parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar per kontrate operatorin ekonomik te papergjegjshem.
I.2 Sqarimet e AK mbi pretendimet tjera te OE
Para se te japim sqarimin tone per kete pretendimet konkrete te OE, e shofim te udhes te perserisim se arsye kryesore e eliminimit ka qene, moskthimi i sqarimeve te kerkuara, madja ne dy/2 raste. Detajet jipen me poshte.

Pika 1. Ne letren tone per sqarim, date 20.09.2023 afati per pergjigje ka qene deri me 22.09.2023 ne ora 10:00. Ju me 21.09.2023 ne ora 11:23 e keni shkarkuar letren tone (shiko deshmine nga platforme e e-prokurimit si DESHMIA 1) por nuk keni kerkuar zgjatje te afatit. Edhe pse sqarimi i juaj i pare ishte i vonuar, AK kesaj radhe e ka pranuar kete sqarim por, eshte cilesuar si sqarim qe bie ne kundershtim me deklarimin tuaj ne oferte.
Ne letren tone derguar te ju me 25.09.2023, afati per pergjigje ka qene deri me 27.09.2023 ne ora 10:00.
E potencojme qe sqarimi yne i dates 25.09.2023 ka qene vazhdimesi per kerkesen e njejt, sikurse ne letren tone te dates 20.09.2023. Ju pergjigjen e keni kthyer me 27.09.2023 ne ora 16:19 (pas orarit te punes-shiko DESHMI 2) dhe ne kete kohe komision kishte perfunduar vleresimin dhe kishte nenshkruar raportin e vleresimit. As ne kerkesen tone te dyte ju nuk keni kerkuar zgjatje te afatit. Sikur te kerkonit, ne do e zgjasnim afatin siç kemi bere dhe bejme ne shume raste, por ju nuk keni kerkuar zgjatje te afatit.
Ne letren e pare standarde per sqarim te tenderit, date 20.09.2023, ne kemi ceke kete *"asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk do te pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues."*
Ju, kesaj radhe keni bere ndryshim te ofertes fillestare e me kete edhe te deklarimit tuaj, sepse me oferte keni deklaruar se bageri eshte prone e OE Bageri, ndersa fatura ka qene si pagese nga OE Bageri te DIMAX KOSOVE dhe e keni marre bagerin ne shfrytezim me marrveshje (shiko DESHMINE 3). Ne sqarimin e juaj te dates 27.09.2023 ne ora 16:19 (e dorezuar pas afatit), keni deklaruar se Bageri tani qenka prone e juaja, pra e "keni blere" para se te publikohet/dorezohet tenderi por "keni harruar" ta dorezoni". Sikur kontrata e blerjes te

dorezohej me oferten fillestare, per AK dhe komisionin ketu do perfundote trajtimi i kesaj çështjeje, do pranohej kjo deshmi dhe do vazhdohej tutje por ju keni rene ne deklarime diametralisht te kunderta, njehere e kemi me marreveshje me OE Bageri, e heren tjeter "e kemi blere". Ne kete pike, komisioni ka kerkuar sqarimet shtese, sepse deklarimet e juaja ishin te dyshimta me baze, pra dyshimi ishte i bazuar. Kerkesat per deshmi shtese, ne letren tone te dyte, ishin te cekura ne dosjen e tenderit, si "**Kontrata e shit-blerjes**" ose "**fatura e pageses**" ose "**zhdoganimit**", por ne momentin e deklarimit kontradiktor, komisioni ka qene i obliguar te kerkoj keto deshmi. Ju ne vend se ti dorezoni ato, ne letren e juaj te dates 27.09.2023 (leter e vonuar) keni deklaruar "nese e kerkoni ua sjellim". A nuk i kishim kerkuar deshmite ne letren tone te dates 25.09.2023?! Si ka mundesi komisioni i vleresimit qe, pas gjithe ketyre deklarimeve te juaja, ne letrat e juaja situata te trajtohej ndryshe?! **Mbi keto qe u thane, pretendimi ne piken 1 cilesohet i pabazuar.**

Pika 2. Rreth pikes 2, ku OE pretendon se transaksioni apo pagesa e bere permes e-banking nuk eshte e sakt sepse, AK deklaron se transaksioni eshte i deshmuar permes kontraes se bere te Noteri si dhe fatures se paguar permes bankes, te noterizuar poashtu te noteri (shiko DESHMIA 4). AK nuk ka çka i shton me teper kesaj deshmie. **Mbi keto qe u thane, pretendimi ne piken 2 cilesohet i pabazuar**

Pika 3. Rreth pikes 3, ku OE deklaron se OE i rekomanduar nuk e ploteson kerkesen per se paku dy-2 teknik te kualifikuar te ndertimtarise, gjoja "... ku OE e ka z. Shaqir Halitin i cili qenka teknik i arkitektures e jo teknik i ndertimtarise", AK deklaron se OE Beni Company, ne kuader te stafit per teknk te ndertimtarise ka deklaruar dy anetar stafi:
1-Mergim B.Ramadani-Teknik i ndertimtarise
2-Shaqir S.Haliti-Teknik i ndertimtarise.
Qe te dy kane diploma identike **Lemia "Ndertimtari"**, ku njeri nga ta e ka **profilin "beton punues"** e tjetri e ka **profilin "arkitekture"**(shiko DESHMIA 5). Sikur te ishte e sakt ajo qe ju pretendoni, atehere edhe per teknikun tjeter po u dashka te thuhet se as tjetri nuk eshte teknik ne ndertimtari, sepse profilin e paska "beton-punues"?!. AK deklaron se kjo kerkese eshte plotesuar nga OE Beni Company. **Mbi keto qe u thane, pretendimi ne piken 3 cilesohet i pabazuar.**

Ne lidhje me deklarimin fillestar te OE ankues se, bageri eshte ne pronesi te OE Bageri dhe te ne me marreveshje (si ne deshmine 3), ndersa ne deklarimin e dyte se "eshte blere", AK konsideron se kjo duhet te jete lende per sqarim te metutjeshem nga dhe me OSHP-n, prandaj AK do kujdeset qe kjo te trajtrohet ne perputhje me ligjin.

Bazuar ne argumentet e mesiperme, AK e cileson Kerkesen per Rishqyrtim te PA BAZUAR

Sinqerisht,
KRU"PRISHTINA Sh.A.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Pretendimi 1

OE ankues pretendon se: *"Ne kerkesen e DT eshte kerkuar qe: 5. Operatori Ekonomik me tendering e tij duhet te vertetoje se ka ne pronesi te vet nje bager ose mini-bager per nveojat e ekzekutimit te projektit. Deshmia 5. Kontrata e shitje-blerjes se pajisjes ose fatura e pageses ose dokumentet per zhdoganimin e pajisjes. Ne ne oferte kemi dorezuar listen mareveshje me Bageri Company mandej ne kerkesen e juaj per sqarim ne ju kemi dorezuar kontraten te cilen e kemi me company Bageri edhe eshte plotesuar kjo kerkes e juaj. Kerkesa per leter sqarim nuk na eshte ardhun ne e-mail mirpo kete e kemi verejtun pase telefonates nga zyra e [rokurimit, dhe ne ate jemi pergjigjun si AK- duhet te respektoni nenin 38.6 ku ceket se AK duhet te kerkoj afat kohore te arsyeshem. Ne kemi ofruar kontraten me Bageri Company e cila kontrate eshte originale dhe e kemi cekun se ne e posedojm eskavatorin ne punishte tone, ju kemi dhene sqarim qe nuk eshte kerkuar transaksioni bankare as fatura."*

Sa i përket pretendimit të parë, eksperti shqyrtues sqaron se pasi që OE ankues nuk i kishte përmbushur kërkesat sipas DT-së sa i përket pikës 5, që operatorët të kenë në pronësi një bager ose mini-bageri i cili duhet të dëshmohet përmes kontratës së shit-blerjes ose faturës ose dokumentit të zhdoganimit, ku OE ankues kishte ofruar dëshmi listën e makinerisë ku OE ankues deklarohet se makina qe posedon është në pronësi të një operatori tjetër, përkatësisht të Bageri. Autoriteti Kontraktues përmes një kërkese për sqarim të bërë herën e parë kishte kërkuar që të dërgohet dëshmia sipas kërkesave të DT-së, ku sipas AK, OE ankues kishte deklaruar se tani ka kontratë të shit-blerjes dhe një gjë e tillë kishte ngritur dyshime te komisoni i vlerësimit, ku AK për këtë arsye, me datë 25/09/2023 kishte bërë edhe njëherë kërkesë për sqarim, duke kërkuar nga OE ankues që brenda një afati të paraparë, përkatësisht deri më datë 27/09/2023 në ora 10:00 të dërgoj dëshmi të tjera si kopje e transaksionit mbi pagesën e bagerit të blerë përkatësisht kopjen e faturës së paguar nga ana e Operatorit ose kopjen e noterizuar të kontratës ose kopjen e lejes se qarkullimit në emër të kompanisë. Pas kësaj kërkese, eksperti sqaron se OE ankues nuk i është përmbajtur afatit të caktuar nga AK për të sqaruar atë kërkese dhe madje nuk kishte bërë asnjë kërkesë shtesë për shtyerje të afatit.

Duke u bazuar në Neni 38, Sqarimi i Tenderëve, përkatësisht pika 6 dhe 7 e këtij neni theksojnë si në vazhdim: *38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre; 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet.* OE ankues pretendon se nuk ka marr njoftim përmes e-mailit, andaj i i është përgjigjur me vonesë kësaj kërkesë të AK-së, përkatësisht përgjigja është kthyer me datë 27/09/2023 në orën 16:35, pra disa orë pas afatit të caktuar, duke marr parasysh faktin se OE ankues nuk kishte bërë as kërkesë për shtyerje të afatit, mendimi i ekspertit është që pasi që OE nuk i është përgjigjur AK-së në kërkesën për sqarim me kohë, sipas legjislacionit, përkatësisht dy neneve të lart-cekura, përgjigja pas afatit

nuk mund të pranohet. Andaj nga ajo se çfarë sqaruam më lartë, konsiderojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i pabazuar.

Përgjigjet e juaja mbi kete çështje, duhet te pranohen me shkrim duke i ngarkuar ne platformën për e-prokurim, *deri me datën* ***27.09.2023 ora 10:00.***

Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Sinqerisht,
KRU PRISHTINA SH.A.

Dërguar nga : NIKA PrO- Ing SH.P.K.
Dokumenti për dërgim te AK
Sqarimi 2.pdf 27.09.2023 16:35
Hape: Shqip

Pretendimi 2

"Ne ne qasjen e dokumentacionit te OE I rekomanduar per kontrate kemi verejtun se pagesa e bere perms e-banking nuk eshte e sakt sepse per pjesen e pare jane dy data e sistemit I e-banking nuk mund te jep dy data per nje pages, kerkojm ta vertetoni nese keni interes ju si AK-qe ti kerkon qarkullimin banker kesaj kompanie pasi ka mos perputhje te dative te transaksionit. Kjo po e kupton qe eshte shtyp flet pagesa 07.02.2021 ende pa u kryer pagesa 08.02.2021."

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i ngritur nga OE ankues nuk është i bazuar, për faktin që përveç dy transaksioneve bankare të realizuara dhe të bashkëngjitura në ofertë nga OE i rekomanduar, si dëshmi për blerjen e mini-eskavatorit, po ashtu bashkëngjitur gjendet edhe deklarata nga Noteri, përmes të cilës shihen qartë datat e shit-blerjes së kësaj pajisje dhe mënyrat e realizimit të pagesave, ku edhe data e kësaj deklarate përmes të cilës pranohet se shuma e parë e pagesës është e realizuar, është në përputhje me dëshminë e parë të pagesës, përkatësisht të dy këto dokumente kanë datën e njëjtë, 08/02/2021 që vërtetojnë vlefshmërinë e tyre.

Pretendimi 3

"OE i rekomanduar nuk e ploteson kerkesen KErkesa 3.Se paku dy-2 teknik te kualifikuar te ndertimtarise. OE e ka z. Sh.H I cili eshte teknik i arkitektures nuk eshte teknik i ndertimtarise, pasi qe drejtimi ndertimtari duhet te jete edhe lemia ndertimtari qe te plotesohet ky kusht. Gjithashtu nuk eshte respketuar edhe kriteri kryesor per dhenie te kontrates e qe ka qene tenderi I pergjigjshem me cmimin me te ulet siç paraqshihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 I LPP-se, sepse e keni rekomanduar per kontrate operatorin ekonomik te papergjegjshem."

Sipas DT-së, një ndër kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ka qenë që OE të ofrojnë *së paku dy teknik të kualifikuar të ndërtimtarisë,* dhe kjo të dëshmohet përmes diplomës ose certifikatës rreth përgatitjes profesionale. Eksperti pasqyron që OE i rekomanduar për z. Sh.H ka sjellur diplomë në lëminë e Ndërtimtarisë, por në profilin e Arkitekturës. Një diplomë e tillë sipas ekpsertit nuk mund të konsiderohet se e përmbushë kriterin e tenikut të ndërtimtarisë, për arsye se ndërtimtaria dhe arkitektura janë dy drejtime të ndryshme. Një diplomë me profil arkitekture, nuk mund të konsiderohet se përmbushë kriterin e DT-së për të qenë teknik i ndërtimtarisë, andaj AK ka pranuar një diplomë e cila nuk është në pëputhje me kërkesat e DT-së të cilat janë përpiluar nga vet ata. Nga kjo çfarë sqaruam, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i bazuar.

Përfundim

Duke marr parasysh që në këtë aktivitet prokurimi kanë ofertuar vetëm dy Operatorë Ekonomik dhe nga shqyrtimi i provave dhe fakteve del se asnjëri prej tyre nuk ka përmbushur në tërësi kërkesat e DT-së përmes të cilës mund të rekomandohet për kontratë, atëherë situata reale bënë të pamundur vazhdimin e mëtutjeshëm të këtij aktiviteti prokurimi, andaj eksperti rekomandon që në këtë situatë, ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimit për dhënie të kontratës dhe aktiviteti duhet të anulohet.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi